



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. regjistri 5/2018 (JR),
datë 11.6.2018

Tiranë më 11.7.2018

**SHPALLJE
E
NJOFTIMIT PËR SHQYRTIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet e procesit si dhe të gjithë personat e interesuar, se ditën e Enjte, në datën 26.7.2018, ora 10:00, do të shqyrtohet në dhomë këshillimi çështja Nr. 5/2018 (JR), datë 11.6.2018, për ankimin që subjekti i rivlerësimit, z. Besim Trezhnjeva, ka bërë kundër Vendimit Nr. 14, datë 13.4.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykses, përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesues i Trupit Gjykses	Ardian Hajdari
Relator i Çështjes	Luan Daci
Gjyqtare	Ina Rama
Gjyqtare	Rezarta Schuetz
Gjyqtar	Sokol Çomo

Kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë para seancës së shqyrtimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe në faqen e internetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe, me njoftim individual në të dhënat elektronike të kontaktit të subjektit të rivlerësimit të deklaruara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit si dhe të dhënat elektronike të Institucionit të Komisionerëve Publikë.

**RELATORI I ÇËSHTJES
GJYQTAR
Luan Daci**

**KRYESUESI I TRUPIT GJYKUES
GJYQTAR
Ardian Hajdari**